



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1800 Prot.

Roskovec, më 01 . 10 2024

VENDIM

NR 96 . DATË 30 . 09 . 2024

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT  
BASHKIAK PËR MUAJIN GUSHT 2024”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI :**

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 29.08.2024, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Gusht 2024.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Afrim Plaka**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6875/1 Prot.

Roskovec, më 30.08.2024

Procesverbal Nr.9

*-I mbajtur sot, datë 29.08.2024, ora 13<sup>00</sup>, në mbledhjen e Këshillit të Bashkisë, mbledhje e radhës, me rend dite :*

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Korrik 2024.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Korrik 2024.
5. Për zëvendësimin e përfaqësuesit të Këshillit të Bashkisë Roskovec në Këshillin e Qarkut Fier.
6. Për anulim të Vendimit Nr.48 datë 31.07.2024 "Për miratim të përdorimit të fondit të emergjencave civile për vitin 2024.
7. Për miratim fondesh shtesë në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2024.
8. Për miratim të përdorimit të fondit të emergjencave civile për vitin 2024.
9. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes së mbledhjes: 13<sup>05</sup>

Këshilltarët prezent: A.Plaka, A.Lamaj, E.Çepele, F.Hoxha, L.Goga, E.Buzi, E.Kaçeli, N.Zeka, H.Hajdini, E.Toska, Dh.Malka, J.Begaj, V.Çepele, A.Pelo S.Bibo Qamili.

Këshilltarët që mungojnë: Rr.Hazizi, Zh.Metushi, E.Xhaxhaj, P.Toro, A.Hoxha, F.Feleqi.

Prezent nga bashkia: Nënkryetari M.Goga, Dr.Ekonomisë S.Çepele, Juriste S.Kuka, Sp/Shërbimit Social S.Saliaj.

Me plotësimin e kuoromit, Kryetari hap mbledhjen. Prezent në fillimin e mbledhjes janë 15 këshilltar. Kryetari –përpara se të miratojmë rendin e ditës të kësaj mbledhje, do doja tju jepja një informacion në lidhje me një nga vendimet e këshillit që kemi marr mbledhjen e kaluar, është pikërisht vendimi Nr.46, vendim i cili kishte disa nënçështje, nënpika dhe është bërë për arsye administrative dhe asaj çfarë duhet të kalonte në Prefekturë, është bërë një ndarje e këtij vendimi

në dy pjesë, pjesën që shkonte në Prefekturë dhe pjesën që qëndronte këtu. Me rendin e ditës besoj që jeni njohur të gjithë. Ka dikush diçka për të diskutuar në lidhje me rendin e ditës? Nuk kemi as shtesa as ndryshime.

### 1.Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.

Kryetari hedh në votim rendin e ditës dhe miratohet unanimitisht me 15 vota pro.

### 2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Korrik 2024.

Sekretarja sqaron informacionin në lidhje me vendimet e miratuara mbledhjen e kaluar, si dhe ndarjen e vendimit në dy pjesë për arsye formale si u shpjegua më sipër, vendimet normative të dërguara në Prefekturë, si dhe miratimin e tyre. Nga 3 vendime normative, 2 vendime janë miratuar, 1 vendim nuk është miratuar, VKB Nr.48.

### 3..Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.

Kryetari- të nderuar këshilltarë, duke qënë se jemi në muajin Gusht, dhe le të themi se është kohë pushimesh dhe materjali i mbledhjes së kaluar ka qënë goxha voluminoz, procesverbali që ju keni është procesverbali i mbajtur gjatë asaj mbledhje me shkrim dore dhe jo i daktilografuar edhe njëherë nga e para. Kjo nuk ndryshon asnjë gjë, sepse është i njëjti material që duhej të hidhej, por për shkak se ishte shumë voluminoz, e kemi shpërndarë në formën bruto të tij, në formën që është mbajtur gjatë mbledhjes së muajit të kaluar. Leksi- kam një mendim, ler të jetë me shkrim original, sepse kjo do jetë super punë, dhe kështu është shkrim i kuptueshëm. Kryetari- kjo është absolutisht e njëjta gjë, por meqënëse çdo herë e kemi ndarë të shtypur. Leksi- biles kjo është me origjinale. Kryetari- të dyja kopjet ruhen edhe në arshivë, edhe ajo që shkruhet edhe njëherë, sepse shkrimi është më shumë për lehtësi leximi. Ky ishte shkrim i kuptueshëm, ti ke shumë të drejtë.Hidhet në votim procesverbali i mbledhjes së kaluar dhe miratohet unanimitisht me 15 vota pro.

### 4.Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Korrik 2024.

P/Shërbimit Social Sidorela sqaron projekt-vendimin sipas materjalit të paraqitur. Dua të shpjegoj dhe për një pyetje që ka bërë z.Elmaz. Elmazi-e kam marr përgjigjen nëpërmjet zyrave unë si individ,faleminderit. Dhurata-duke parë që ne materjalet i kemi këtu, i kemi lexuar dhe rilexuar, kështu që mendoj që mos të ndalet më gjatë vajza. Nuk ka më pyetje dhe diskutime. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet unanimitisht me 15 vota pro.

### 5. Për zëvendësimin e përfaqësuesit të Këshillit të Bashkisë Roskovec në Këshillin e Qarkut Fier.

Kryetari-ashtu siç morëm vendim në mbledhjen e kaluar të Këshillit Bashkiak, me kërkesë të vet ish anëtares së këshillit u ndërpre mandati i znj.Esmeralda Musko. Znj.Esmeralda Musko ka qënë e mandatuar nga ky Këshill të ishte përfaqësuese pranë Këshillit të Qarkut. Automatikisht në momentin që ndërpritet mandati i këshilltarit, atëherë ne do të miratojmë dhe ndërprerjen e mandatit të Këshillit të Qarkut të znj.Esmeralda, dhe për procedurë në vijim duhet që nga ky

Këshill të caktojme një anëtar tjetër që ta përfaqësojë Këshillin e Bashkisë Roskovec pranë Këshillit të Qarkut. Sekretarja e këshillit- unë dua të theksoj se duhet të jetë nga e njëjta gjini, që të ruhet barazia gjinore, pra të ruhet raporti i barazisë gjinore, dhe duhet të jetë gjinia femër. Kryetari- ashtu siç u veprua në rastin e zëvendësimit të znj.Esmeralda që nga lista emërore e partisë politike përzgjidhet anëtari tjetër që është në radhë dhe duhet ti përkasi të njëjtës gjini, i njëjti rregull vlen dhe për përcaktimin e anëtarit zëvendësues në Këshillin e Qarkut. Përsa kohë që mandati është i ndërprerë, ajo që ne do të bëjmë në këtë mbledhje është që do të presim propozimet dhe më vonë do të votojmë për anëtarin e ri për në Këshillin e Qarkut. Sapo ju sqarova që propozimi duhet të jetë një anëtare, pra një shoqe për të respektuar barazinë gjinore. Jorgo- dhe në emër të opozitës, por dua që të gjej dhe mirëkuptimin tuaj, meqënëse këtu në Këshill kërkohet bashkëpunimi pozitë-opozitë, dhe duke parë ecurinë e këtij Këshilli, kërkojë që dhe nga ana juaj, ne e dimë që ju i keni votat dhe firmosni vulosni vet, por kërkojë që dhe në emër të grupit të bëjmë një bashkëbisedim ose një marrëveshje, që dhe me mirëkuptimin tuaj, që dhe gjërat atje në Këshillin e Qarkut mos të jenë vetëm nga pozita por të jenë dhe nga opozita. Në qoftë se do gjejmë dakortësi siç na kërkoni dhe ju, është e mira që kandidatura të jetë një kandidaturë e jona nga opozita, me mirëkuptimin e gjithë anëtarëve të Këshillit. Dhurata-duke parë ecurinë se ne kemi 1 vit e gjysmë që jemi këtu, takim pas takimi, mbledhje pas mbledhje dhe ne e dimë si funksionon, atëherë në emër të katër përfaqësuesve që ne jemi këtu, kemi dhe ne një emër, dhe ne si grup propozojmë znj.Elisabeta Toska. Se në mbledhjen e Kryetarëve të Grupit sikur patëm disa diskutime, se Maksi Nënkryetari ishte edhe vet, apo Mira Nënkryetarja, jo se na mbështeti se nuk erdhi për të votuar për Tecin, kjo ska lidhje fare sepse në fund të fundit nëse ska ardhur ka bërë mirë për jetën e saj dhe familjarët e vet, por thjesht kështu e ndiejmë ne si grup, kështu që të paktën ne që jemi këtu prezent propozojmë znj.Elisabeta Toska,faleminderit. Kryetari-ne nuk mund të gjykojmë këtë Këshill të nderuar të tipit që vet firmosim vet vulosim, kuptohet që është vota dhe numri i votave ai që vendos në fund, dhe këto janë procedura mëse demokratike dhe çdo gjë shprehet me votë. Nuk besoj se është i tipit sesi e trajtoi i nderuari z.Jorgo. Leksi- meqënëse dhe kolegu im Gogua tha që duhet të jemi në një marrdhënie ndërmjet pozitë-opozitë për propozime për anëtar të Këshillit të Qarkut, unë mbështes Gogon, mbështes njëkohësisht dhe propozimin e Dhuratës që është Kryetare e Grupit të Partisë Demoktatiqe, lër të jetë Elisabeta Toska. Kryetari- z.Leksi ju flisni në emër të grupit? Leksi- po. Kryetari- procedura parashikon rastet kur ne kemi konsensus mund ta bëjmë votimin të hapur. Leksi- është votim i hapur. Dhurata-unë pretendoj që ta bëjmë votimin të hapur. Maksi- në ligj shkruhet shprehimisht që votimi për anëtarët e Këshillit të Qarkut bëhet i fshehtë,se kthehet nga Prefektura. Sekretarja- në rast se ka 1 propozim të vetëm mund të bëjmë dhe me votim të hapur, nëse janë 2 propozime me votim të fshehtë, por këtë e vendos Këshilli. Kryetari- jemi në kushtet që kemi vetëm 1 propozim, për procedurë më duhet të tërhiqem 2 minuta sa ta sqarojë. Kryetari- lër të shprehen për procedurë të hapur të dy Kryetarët e Grupeve. Elmazi-më vjen mirë që i gjithë Këshilli Bashkiak është me një kandidaturë për në Këshillin e Qarkut, por mendimi im është që të zbatohen rregullat dhe procedurat, pavarësisht se ne jemi të gjithë të një mendje,por ajo duhet bërë me votim. Ky është mendimi im si Kryetar i Grupit. Kryetari- për procedurë duhet të ngrihet Komisioni i Votimit. Zgjidhet Komisioni F.Hoxha Kryetar, V.Çepele Zv/Kryetar dhe H.Hajdini Sekretar i komisionit. Komisioni përgatit fletët e votimit dhe listën e votuesve. Kryetari sqaron mënyrën sesi duhet të plotësohet fleta e votimit,mënyra e votimit do të jetë duke vendosur shenjën në krahë të emrit të kandidatit. Çdo shenjë e vendosur është një votë Po, çdo shenjë e munguar aty, është Jo. Fillon procesi i votimit të

fshehtë. Këshilltarët vijnë një e nga një sipas listës dhe votojnë. Mbaron votimi. Komisioni hap kutinë e votimit, numëron fletët e votimit dhe përgatisin procesberbalin. Kryetarja e Komisionit Floriana lexon procesverbalin e mbajtur. Në kutinë e votimit u gjetën 15 fletë votimi të gjitha të vlefshme, të votuara Po për znj. Elisabeta Toska. Nga rezultatet e votimit të fshehtë, me 15 vota unanime anëtarja e re e Këshillit të Qarkut zgjidhet të jetë znj. Elisabeta Toska, e cila zëvendëson në këtë pozicion znj. Esmeralda Musko. Këshilltarët i urojnë suksese Elisabetës. Kryetari- duke falenderuar Komisionin e votimit, duke ju falenderuar të gjithë ju anëtarë të Këshillit që morët pjesë në këtë votim, i uroj suksese znj. Elisabeta.

6. Për anulim të Vendimit Nr.48 datë 31.07.2024 "Për miratim të përdorimit të fondit të emergjencave civile për vitin 2024.

Juristja Sara Kuka sqaron projekt-vendimin. Në këtë moment këshilltarja Sara paraqitet pranë Kryetarit dhe Sekretares dhe kërkon leje për tu larguar pasi nuk ndihet mirë, si dhe deklaron votën e saj pro për pikat e mbetura të rendit të ditës. Tani në sallë prezent 14 këshilltar. Juristja-ky vendim që po anulohet është miratuar në mbledhjen e datës 31.07.2024 dhe është dërguar në Prefekturë për konfirmim ligjor. Nga ana e Prefektit të Qarkut Fier ky vendim është kthyer pasi bie në kundërshtim me VKM-në 414. Për këtë arsye ky vendim duhet të anulohet sipas procedurës ligjore. Dhurata- së pari doja ti thoja vajzës për ta korrigjuar pak, ose më mirë ta theksonte vajza që u miratua nga pozita dhe jo nga opozita, sepse ne ishim 6 vota kundra aq sa ishim atë ditë, ta kishte theksuar do ishte më mirë, dhe së dyti duke menduar që tek emergjencat civile bëjnë pjesë zjarret, përmbytjet dhe tërmetet, normalisht ne ishim ajo pjesa e opozitës që u tërhoqëm nuk e votuam, kështu që i bie që edhe këtë herë nuk do marrim pjesë fare, do abstenojmë si grup. Kaq kisha, faleminderit. Nuk ka më diskutime. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit dhe miratohet me 10 vota pro, 4 vota abstenim nga koalicioni BF. Kryetari- bën me dije se znj. Sara u largua nga salla dhe ka shprehur dakortësinë për dy projekt-vendime në vazhdim, pasi është në pamundësi për të qënë në sallë. Jorgo- në sallë janë 9. Kryetari-z. Jorgo ku bazoheni në numërimin tuaj se në sallë janë 9 ? Jorgo-janë 10 se u ngatërrova në numërim. Kryetari-unë jam i detyruar që ta marr në konsideratë vendimin që mori këshilltarja. Dhurata-ta marrësh në konsideratë? Mund të ketë dhe nga opozita që ata sjanë prezent për arsye shëndetsore. Viola- a nuk duhet të jesh prezent në çdo mbledhje për mendimet pro, kundër, abstenim ? Kryetari-këshilltarja ishte prezent. Viola-po jam dakort nuk po të kundërshtoj, në momentin kur nuk është, për vendimet më pas pse duhet? se po e bëjmë çdo mbledhje dhe ne të tjerët kështu, dhe është mëse normale pastaj. Kryetari-nuk arrini dot që të bëni dallimin e këtij rasti? Dhurata-kjo nuk është e drejtë, është shkelje ligjore. Jorgo-emergjencë nuk është. Dhurata- ose në fund të fundit bëni si të doni sepse ju e keni përgjegjësinë jo ne si opozitë. Leksi- nuk ka kuptim sepse nuk është në sallë. Dhurata- jo që ska kuptim, por është shkelje ligjore. Sekretarja- ky projekt-vendim nuk kërkon shumicë të cilësuar. Jorgo-se ça do shkruani ju atje është tjetër gjë. Kryetari- asnjë gjë nuk shkruhet përveç dëshirës së këshilltares, e cila për një arsye të fortë personale u afrua këtu, shprehu dakortësinë. Ju keni të drejtën të mbani qëndrimin tuaj. Viola- po flas si është rregullorja? Leksi-Arlinda meqë më the që nuk do shumicë të cilësuar, si të dojë shumicë të cilësuar, si të mos dojë shumicë të cilësuar, në rast se këshilltari nuk është prezent, nuk gjen konsensusin e të gjithë këshilltarëve, nuk ka arsye ta shkruajmë numër vote, se do të thotë që edhe unë mos të vij fare, jam në shtëpi atje dhe them që jam për të gjitha projekt-vendimet pro. Kryetari-absolutisht që nuk është shënuar numër vote, unë mendova përsa

kohë ajo u afrua dhe shprehu mendimin e saj, se kishit konsensusin. Kryetari- projekt-vendimi miratohet, mjaftojnë 10 vota, nuk duhet shumicë e cilësuar. Leksi- dhe sikur të duhej shumicë e cilësuar do anullohej. Jorgo-nëse të njëjtën gjë që bën radhën e parë, të bëjnë edhe këtë radhë, qofshin ata që janë.

#### 7.Për miratim fondesh shtesë në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2024.

Kryetari- ftoj Drejtorin e Financës Selmanin për të relatuar në lidhje me këtë projekt-vendim, dhe do doja që ti kujtoja nëse për këtë projekt-vendim ka ndonjë korrigjim lapsusi. Selmani- ky projekt-vendim ka të bëjë me akordimin e fondit në formën e grantit specifik të pakushtëzuar, i cili është konkretisht për arsimin parashkollor dhe zjarrfikset, si pasojë e rritjes së pagave e cila ka filluar nga 1 Korriku i këtij viti. Sqaron detajimin e fondit të akorduar për rritjen e pagave për funksionin e arsimit parashkollor edukatoret, dhe për funksionin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi. Ky fond është i akorduar për këtë vit, sepse për vitin tjetër do ketë politika të tjera të rritjes së pagave, e ndarë në paga dhe sigurime shoqërore. Ky fond përdoret deri në Dhjetor të këtij viti. Edhe për 2024 është e njëjta shumë dhe me të njëjtët artikuj 600,601. Kryetari- ju thashë në fillim të ligjëratis tuaj z.Selman në lidhje me një lapsus që ta shprehësh. Selmani- sqaron lapsusin tek tabela e dyte, tek kolona e 2024. Kryetari- të lutem ti referohesh saktë që edhe këshilltarët të kenë mundësi që ta shikojnë në projekt-vendim. Selmani- shuma është po ajo 4,101,877, po kaq është dhe për vitin 2024 por i ndarë në artikuj 600,601 është bërë një lapsus, por u konfirmoj që të njëjta shuma janë dhe për vitin 2024. Kryetari- shprehi shifrat. Selmani- artikulli 600 3,515,000 dhe artikulli 601 sigurimet shoqërore 586,877 lekë. Kryetari- pra shuma është e barabartë. Dhurata- mund të më thuash për kurjozitet më tepër, sa është numri i edukatoreve? I gjithë ky fond që është akorduar për edukatoret, sa është numri i edukatoreve për bashkinë tonë ? Përfshihen edhe ata që kujdesen për 3 vjeçarët, çerdhet apo jo? Aty është e theksuar për edukatoret, por se gjithë ky fond kaq i madh për këtë sezon kaq të shkurtër, se tani dhe sa muaj kanë mbetur dhe 4 muaj mbeten. Selmani-janë 6 muaj. Dhurata-se ka filluar rritja, tani si kalon ky fond? Selmani- se rritja ka filluar nga 1 Korriku, dhe ky fond është nga 1 Korriku i këtij viti. Dhurata- ky është fond jashtë Ministrisë, si është ky fond? Selmani- është fond i akorduar nga Ministria e Financave. Dhurata-domethënë që edukatoret e kanë plus, meqënëse e kanë një rritje? Selmani-ky fond mbulon rritjen e pagave. Dhurata- sa është numri i tyre? Selmani-34 për arsimin parashkollor. Nuk ka më pyetje dhe diskutime. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas korrigjimit të lapsusit si më sipër dhe miratohet unanimit me 14 vota pro.

#### 8.Për miratim të përdorimit të fondit të emergjencave civile për vitin 2024.

Selmani-bazuar në materjalin e sjellë nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, preventivit përkatës dhe relacionit bashkëngjitur, kërkojmë miratimin e fondit të paraqitur si në projekt, për objektin “Sistemimi i shkarjes së varrezave Kurjan” i cili do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i emergjencave civile për vitin 2024. Në bazë të relacionit dhe materjaleve të sjella, mendojmë se ky objekt është emergjent dhe kërkon ndërhyrje patjetër, dhe kërkojmë miratimin e këtij projekt-vendimi. Dhurata-Selmani ndoshta ka të drejtë që thotë është emergjent, ne skemi asgjë me rikonstruksionin e murit të varrezave, normalisht kemi respekt për të rënë, qofshin të paharruar ata, por unë e kam shqetësimin sepse mund ta çojmë prapë në Prefekturë sikurse e kaluat ju herën e

kaluar, e morët çështje emergjente, ndërkohë ajo nuk doli emergjente z.Selman, dhe nëse e përsërisim të njëjtën gjë, mos bie pak ndesh mendoj unë, kështu që ne si grup më mirë po abstenojmë. Se kështu e ndjejmë, ska arsytim tjetër, e njëjta situatë është, jo për murin e varrezave të Roskovecit por ta kthejmë të Kurjanit. Ne thamë mos ta përsëris përsëri që janë zjarret, tërmetet, përmbytjet. Tani do thoni ju shkau dheu, e njëjta strukturë ishte dhe tek varrezat e Roskovecit dhe si mundet ta kalojmë? Ne dolëm kundra muajin e kaluar, ose më mirë të them që dolëm abstenim sepse nuk ishte emergjente, ndërkohë të njëjtën gjë ju po e kaloni përsëri si emergjente, ju e dini. Në këtë moment vjen përsëri në sallë anëtarja e cila u largua pak më parë znj.Sara. Prezent 15 këshilltarë. Maksi-ne menduam që është një fond rezervë, ky fond rezervë digjet. Dhurata-kështu thatë dhe herën e kaluar por ja u kthye. Maksi-nga ana jonë nuk u paraqit një relacion bindës nga Ekzekutivi në Prefekturë, për të plotësuar ato kritere që duheshin plotësuar, ishte një përgjegjësi e jona si Ekzekutiv. Nuk është e njëjta situatë si tani, se të gjitha fotografitë që janë bërë atje, nga shirat që ranë atje, ka një problematikë të theksuar në varrezat e Kurjanit. Dhurata-pse në Roskovec nuk ishte e njëjta situatë? Maksi-jo ishte mur, ndërsa atje po dalin dhe eshtrat. Selmani-ndryshon terreni,nuk është i njëjti terren. Elmazi- I nderuar shef i financës, paraqet dy herë të njëjtin relacion me të njëjtin problem, të cilën Prefektura e ktheu me të drejtën e saj ligjore. Unë ju shtrojë pyetjen juve si shef i financës, ku hyn ky fond i emergjencave civile? Nuk ma mer mendja që fondi i emergjencave duhet të hyj në bërjen e murit të varrezave, të më falin të gjithë ata që po themi, por hyn në fatkeqësi natyrore, në tërmet ose në përmbytje, dhe nuk hyn në këtë punë. Selmani-në bazë të vendimit 414 pika përkatëse, në këtë pikë që ne ju kemi paraqitur, pika b ka të bëjë me ndërhyrjet në infrastrukturë. Elmazi-pse duhet të hyj fondi i emergjencave në atë pikën b ? Selmani- sepse për fondin e emergjencave është 414-ta. Jorgo-kemi dhe nja 4 muaj, mos ndodh ndonjë emergjencë tjetër ? Leksi-këto dy projekt-vendime që kanë ardhur, më ngjan se në koncept janë të njëjta dhe ndoshta duhet të ndryshojë koncepti emergjente, sepse nuk ka emergjencë në murin e varrezave të Roskovecit, që nuk kishte sepse ai mur ka qënë këtu e 20 vjet më përpara. E njëjta gjë dhe për murin e varrezave Kurjan, pavarsisht se Drejtori i Financës tha se është terren i vështirë, relief malor por nuk është e njëjta. Këtu mesa kuptoj unë, se dhe anën juridike nuk e njoh shumë mirë, duhet hequr nocioni “emergjencë”. Të kaloj fondi meqë digjet, domethënë janë ato procedurat e anës financiare që mund të digjet brenda muajit, por të kalosh në emergjencë nuk kemi pse ta themi, dhe të jenë të qartë dhe në projekt-vendim dhe në materialet që sjellin zyrat përkatëse, ti shmangin këto gjëra në mënyrë që të mos anulohet, ky është mendimi im. Ndërsa për çështje fondi në rast se digjet, hajt ta kalojmë dhe atyre tu bëhet një respekt. Kryetari-para se ta hedhim në votim këtë projekt-vendim, doja ti bëja me dije znj.Sara që dëshira e saj për tu numëruar si votë plus në projekt-vendimet për të cilat nuk ishte prezent në sallë, sipas mendimit që kishin dhe këshilltarët e tjerë, nuk u mor parasysh vullneti juaj, kështu që nuk jeni numëruar në votimet e dy pikave që ju munguat në sallë, dhe pse e kishit shprehur paraprakisht votën tuaj. Kryetari-para se ta hedh në votim i drejtohem edhe një herë z.Selman nëse keni ndryshime në projekt-vendimin e ardhur për miratim, sa i takon emërtimit të këtij projekt-vendimi? Selmani-emërtimi do thënë nga përdorimi i fondit të emergjencave nga fondi i kushtëzuar. Kryetari- ju lutem ta shprehni qartësisht. Selmani- për miratim të përdorimit të fondit të kushtëzuar të emergjencave civile për vitin 2024. Elmazi-para se ti ta hedhësh në votim, unë mendoj që të jemi në rregull me të tëra ligjet, të bëj shkresën ai dhe të na e paraqesi ne këtu ashtu si duhet, atëherë ta hedhim në votë. Jorgo-na e bier ndryshe ta votojmë. Kryetari-të nderuar këshilltar, jo më kot kërkova në një ligjëratë të drejtë të përfshijmë në diskutim formën përfundimtare. Ju ftoj të votoni për projekt-vendimin me

ndryshimin siç po citoj “Për miratim të përdorimit të fondit të kushtëzuar të emergjencave civile për vitin 2024”. Sekretarja-është e shprehur në brendësi të projekt-vendimit, është thjesht një saktësim i titullit. Jorgo-nuk kemi kundërshtim me ju, ne po themi për shkresën që kemi ne, që të ngrejme kartonin. Kryetari-ky ndryshim tashmë u përfshi dhe nuk është precedent,dhe në shumë raste të tjera ne kemi pasur ndryshime të tilla, dhe kjo është procedura normale. Kryetari e hedh në votim projekt-vendimin me ndryshimin si më sipër dhe miratohet me 11 vota pro, 1 kundër V.Çepele, 3 abstenim Dh.Malka,J.Begaj,A.Pelo. Miratohet.

#### 9.Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Kryetari-paraprakisht do doja që të shprehja edhe njëherë përpara këtij Këshilli të nderuar dhe pjesës së administratës që mund të na ndjekin, shqetësimin që unë kam sa i takon ujësjellësit në Njësinë Administrative Kuman. Është një kërkesë që ne e kemi parashtruar në këtë Këshill dhe pranë autoriteteve të Ujësjellës sh.a Fier. Jam në pritje të një vendimmarrje pozitive sa i takon zhvillimeve në atë ujësjellës, sepse diskutojmë për emergjenca, por unë vet e konsideroj si emergjencë civile dhe faktin që Njësia Administrative Kuman duhet të furnizohet me ujë të pijshëm. Dhurata-do doja të ndalesha pak duke qënë se jam banore e fshatit Suk 1 poshtë, unë e thashë paraprakisht dhe në mbledhjen e Kryetarëve atje, e kam vërejtjen në lidhje me kazanët e mbeturinave, çdo kazan nja 200 m2 e zënë vetëm mbeturinat. Ata zotërinjt që pastrojnë kontinierët marrin çfarë ka kazani brenda, se jashtë asnjëherë se marrin mundimin. Brenda lagjeve ata vijnë çdo javë, ama në periferi të fshatrave ata kazanët kanë zënë 200-300 m2 me plehra të hapura, të derdhura që i marrin ata qentë e rrugëve. Është ndotur ambjenti sa të duash, këtë e kam me fakte. Meqënëse po afron viti mësimor, ato shkollat nuk u caktua asnjë gjë, u morrëm me varrezat, sigurisht që mirë bëtë që keni caktuar ato, por asnjë gjë nuk do caktohet për shkollat ? se normalisht ju i lini për muajin e fundit. Maksi-sa u rikonstruktua shkolla. Dhurata-cila shkollë? Shkolla Alush Grepcka vetëm? Çfarë ka ndodhur me shkollën Agaçaj, që janë 25 fëmijë në kopësht dhe ishin aktualisht në Qershor 49 nxënës, dhe një qeskë gëlqere 1200 lekë të vjetra ti kalojnë një pompë asaj shkolle. Ky është fakt z.Maksi, sepse Kryetarja ka ardhur atje do bëj atë rrugën, por sytë si ka hedhur asnjëherë nga shkolla, nga arsimi sepse që aty fillon jeta e çdo personi, sepse arsimi është baza e jetës.Dhe shkolla jonë e madhe atje në qendër që u bë vjet e re, e dini ju z.Maksi se kemi biseduar herë pas here, dhe vet i keni verifikuar ju në lidhje me ato tualetet e shkollës, ato janë të gjitha të prishura. Ne e filluam kemi 1 javë, ato nuk funksionojnë asnjëra, por i hedhim ujë me kova si dikur, si atëherë kur isha unë në 8 vjeçare në 87 a 88. Duhet bërë diçka se nuk u caktua këtë muaj, kur do caktohet? Edhe një javë kemi ne arsimtarët që do bëhet shpërndarja e teksteve, kur do bëhen këto gjëra? Do bëhen apo jo, dua një përgjigje në emër të stafit pasi tualetet janë shumë emergjente për këdo, por edhe për komunitetin, të dëgjojnë edhe prindërit çfarë do ndodhi me këto. Maksi-do bëhen brenda javës tjetër ato që kërkuat ju. Dhurata-do ti jepni gëlqere shkollës Agaçaj? Maksi-po. Dhurata-e sigurt? Sepse minimum 5 qeska gëlqere duhen,minimum 1 qeske gëlqere po kërkojnë mësuesit dhe ata prindër, dhe në lidhje me tualetet 3500 lekë të vjetra është ajo pompa brenda, dhe tualeti i mësuesve është i prishur, jo më tek fëmijët. Lexi-meqënëse jemi në këtë pikë, na ngjan sikur dhe qetësohemi se themi ndonjë problem, por dhe sa janë në qendër të vëmendjes, sesa zgjidhen është problem tjetër. Problemi që ka mbetur pezull dhe nuk kam ndonjë informacion është për Unazën Perëndimore të qytetit. Është e vetmja rrugë mund ta quaj aty në Roskovec në të cilën nuk janë hedhur sytë fare, ka ngelur këtu e

10 vjet që do bëhet Unaza Perëndimore dhe nuk dimë asgjë sesi është fati i saj. 2.Asfaltimi i rrugëve pas punëve që ka bërë ujësjellësi, që e dimë shumë mirë çka pune ka bërë ujësjellësi në Roskovec, është për të ardhur keq, i kanë dhënë një pamje të keqe atyre rrugëve pas riasfaltimit, një asfalt jashtë çdo standarti, me xhunga, me mjete primitive. Ato rrugë nuk shikohem më me sy dhe është gjynah se janë rrugë që janë investuar tani. 3.Problem që e kam ngritur 2-3 herë, dhe një që e ka bërë Gogua, problemi i qenve të rrugës, i qenve rrugaç. Nuk e di se kur do gjejnë ndonjëherë rehat banorët e qytetit të Roskovecit, sepse nuk kanë kursyer asnjë moshë madhore, as minore, as moshë mesatare. Kryetari-është në zgjedhjen tuaj z.Maksi nëse do merrni kohë për ti shqyrtuar këto apo do të jepni përgjigje tani. Nuk ka më diskutime. Kryetari-duke ju falenderuar të gjithëve të nderuar këshilltar, duke i uruar Elisabetës suksese, dhe meqënëse në Këshill pjesa më e madhe i takon arsimit, suksese dhe me krahë të lehta për vitin e ri shkollor. Mbyllet mbledhja.

**Sekretar**

**Arlinda Hajdini**



**Kryetar**

**Afrim Plaka**

